



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.277/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, paraqitur kundër Teuta Haxhiut kandidate për deputete nga Koalicioni PDK-AAK-NISMA, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 13.06.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, ashtu që Koalicionit PDK-AAK-NISMA, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 300 (treqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

Me datën 12.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me të cilën pretendon se Teuta Haxhiut kandidate për deputete nga koalicioni PDK-AAK-NISMA ka bërë fushatë në rrjetin social Facebook në ditën e heshtjes zgjedhore dhe në ditën e votimit. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e ligjit për zgjedhjet e përgjithshme. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara në cilësi të provës materiale.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

#### **Ankesa është e bazuar**

Nga shkresat e lëndës shihet se si kandidatja për deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e koalicionit PDK-AAK-NISMA, Teuta Haxhiut gjatë heshtjes zgjedhore dhe ditës së votimit në rrjetin e saj social facebook ka bërë fushatë zgjedhore dhe ka udhëzuar që të votohet nr 12 dhe kandidati për kryeminister Ramush Haradinaj, ku me këtë veprim ka bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Andaj PZAP-i duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se Koalicioni PDK-AAK-NISMA është përgjegjëse për veprimet e saja duke shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku thuhet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja fushatë në çfarëdo mënyre.

Paneli mbi bazën e të dhënave të lartcekuar në mbështetje të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.277/2017 më datën 13.06.2017.



**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*